

WE ARE YOUR DOL



Department  
of Labor

# POLITIKA MBI TË DREJTAT E PUNONJËSEVE PËR SHTRYDHJE TË QUMËSHTIT TË GJIRIT në vendin e punës

## HYRJE DHE QËLLIMI

Seksioni 206-c i Ligjit të Punës të Shtetit të Nju Jorkut u jep të gjithë punonjëseve në Nju Jork të drejtën për të shtrydhur qumështin e gjirit në vendin e punës. Ky ligj zbatohet për të gjithë punëdhënësit publikë dhe privatë në shtetin e Nju Jorkut, pavarësisht nga madhësia ose natyra e biznesit të tyre.

Departamenti i Punës i Shtetit të Nju Jorkut ka zhvilluar politikën zyrtare për shtrydhjen e qumështit të gjirit në vendin e punës siç kërkohet nga ligji, duke siguruar që të gjitha punonjëset të njohin të drejtat e tyre dhe që të gjithë punëdhënësit të kuptojnë përgjegjësitë e tyre. Kjo politikë është standardi minimal i kërkuar, por punëdhënësit nxiten të përfshijnë akomodime shtesë, të përshtatura për vendin e tyre të punës.

Me informacionin e dhënë më poshtë, punonjëset do të mësojnë se sa kohë u mundësohet për shtrydhjen e qumështit të gjirit, llojin e hapësirës që u kërkohet punëdhënësve për të shtrydhur qumështin e gjirit, si t'i njoftojnë punëdhënësit për nevojën për të mbledhur qumështin e gjirit në vendin e punës dhe si të njoftohet Departamenti i Punës nëse këto të drejta nuk respektohen.

Punëdhënësve u kërkohet që të japin këtë politikë me shkrim për të gjitha punonjëset në momentin kur ato punësohen dhe përsëri çdo vit më pas. Punëdhënësve u kërkohet gjithashtu, që t'ua mundësojnë punonjëseve politikën sapo të kthehen në punë pas lindjes së një fëmije.

## PËRDORIMI I KOHËS SË PUSHIMIT PËR SHTRYDHJEN E QUMËSHTIT TË GJIRIT

Punëdhënësit duhet të sigurojnë kohë të arsyeshme pushimi pa pagesë për punonjëset e tyre, me qëllim që të mund të mbledhin qumështin e gjirit. Përveç kësaj, punonjëset duhet gjithashtu, të lejohen të përdorin kohën e pushimit të paguar ose kohën e ushqimit për të shtrydhur qumështin e gjirit. Kjo kohë duhet të sigurohet deri në tre vjet pas lindjes së fëmijës. Punëdhënësit duhet të sigurojnë pushim pa pagesë të paktën çdo tre orë, nëse kërkohet nga punonjësja. Megjithatë, numri i pushimeve të papaguar që një punonjëseje do t'i duhet për të shtrydhur qumështin e gjirit është unik për secilën punonjëse dhe punëdhënësit duhet të ofrojnë kohë të arsyeshme pushimi bazuar në nevojat individuale. Punëdhënësit i ndalohet të diskriminojnë në çfarëdo mënyre një punonjëse që zgjedh të mbledhë qumështin e gjirit në vendin e punës.

Një punonjëse duhet të lejohet të punojë para ose pas turnit të saj normal, për të plotësuar çdo kohë të shfrytëzuar si pushim pa pagesë për të mbledhur qumështin e gjirit, për sa kohë që kjo kohë përshihet në orarin normal të punës së punëdhënësit. Sidoqoftë, një punonjëseje nuk i kërkohet të plotësojë kohën e pushimit të papaguar.

Të gjithë punëdhënësit duhet të vazhdojnë të ndjekin ligjet, rregulloret dhe udhëzimet ekzistuese federale dhe shtetërore në lidhje me kohën e pushimit të paguar dhe të papaguar dhe orarin e ushqimit, pavarësisht nëse punonjësja e përdor këtë kohë për të mbledhur qumështin e gjirit. Për informacion shtesë në lidhje me atë që përbën një periudhë ushqimi ose një periudhë pushimi sipas ligjit shtetëror dhe federal, ju lutemi shihni burimet e mëposhtme:

- Faqja e internetit të Departamentit të Punës të NY mbi Ditën e Pushimit, Kohën e Pushimit dhe Periudhat e Ushqimit [dol.ny.gov/day-rest-and-meal-periods](https://dol.ny.gov/day-rest-and-meal-periods)
- Pyetje të Shpeshta të Departamentit të Punës të NY mbi Periudhat e Ushqimit dhe Pushimit [dol.ny.gov/system/files/documents/2021/03/meal-and-rest-periods-frequently-asked-questions.pdf](https://dol.ny.gov/system/files/documents/2021/03/meal-and-rest-periods-frequently-asked-questions.pdf)
- Pyetje të Shpeshta të Departamentit të Punës FLSA të U.S. mbi Periudhat e Ushqimit dhe Pushimit [dol.gov/agencies/whd/fact-sheets/22-flsa-hours-worked](https://dol.gov/agencies/whd/fact-sheets/22-flsa-hours-worked)
- Fleta e të Dhënave e Departamentit Amerikan të Punës FLSA mbi Kompensimin për Kohën e Pushimit për Shtrydhjen e Qumështit të Gjirit [dol.gov/agencies/whd/fact-sheets/73-flsa-break-time-nursing-mothers](https://dol.gov/agencies/whd/fact-sheets/73-flsa-break-time-nursing-mothers)

Ndërsa një punëdhënës nuk mund të kërkojë që një punonjëse të punojë ndërkohë që shtrydh qumështin e gjirit, asgjë në Ligjin e Punës 206-c nuk e pengon një punonjëse që të zgjedhë vullnetarisht ta bëjë këtë. Koha e punës gjatë nxjerrjes së qumështit të gjirit duhet të kompensohet.

Pushimet e papaguara, të parashikuara për shtrydhjen e qumështit të gjirit, duhet të jenë të paktën njëzet minuta. Megjithatë, nëse dhoma e caktuar e laktacionit ku do të bëhet një pushim i tillë nuk është pranë vendit të punës së punonjësës, pushimi i parashikuar duhet të jetë së paku tridhjetë minuta. Një punonjëse duhet të lejohet të bëjë një pushim më të gjatë pa pagesë nëse është e nevojshme. Punonjëset gjithashtu, mund të zgjedhin të bëjnë pushime më të shkurtra pa pagesë.

Punonjëset që punojnë jashtë zyre kanë të njëjtat të drejta për pushim pa pagesë për qëllimin e dhënies së qumështit të gjirit, si të gjithë punonjësit e tjerë që kryejnë punën e tyre personalisht.

## PARAQITJA E NJË KËRKESË PËR SHTRYDHJEN E QUMËSHTIT TË GJIRIT NË PUNË

Nëse një punonjëse dëshiron të mbledhë qumështin e gjirit në vendin e punës, ajo duhet të njoftojë punëdhënësit paraprakisht, brenda një kohe të arsyeshme, përgjithësisht përpara se të kthehet në vendin e punës, nëse punonjësja është me pushime apo leje. Ky njoftim paraprak është për t'u dhënë kohë punëdhënësve për të gjetur një vendndodhje të përshtatshme dhe për të rregulluar oraret nëse është e nevojshme.

Punonjëset që dëshirojnë të kërkojnë një dhomë ose vend tjetër për të mbledhur qumështin e gjirit në vendin e punës duhet ta bëjnë këtë duke paraqitur një kërkesë me shkrim tek mbikëqyrësi i tyre i drejtpërdrejtë ose individ i caktuar nga punëdhënësi për përpunimin e kërkesave. Punëdhënësit duhet t'i përgjigjen kësaj kërkesë për një dhomë ose vend tjetër për të mbledhur qumështin e gjirit me shkrim brenda pesë ditëve.

Punëdhënësit duhet t'i njoftojnë të gjitha punonjëset me shkrim përmes postës elektronike ose me memo të printuar kur një dhomë ose vend tjetër është caktuar për shtrydhjen e qumështit të gjirit.

## KËRKESAT PËR DHOMËN E LAKTACIONIT

Përveç sigurimit të kohës së nevojshme gjatë ditës së punës, punëdhënësit duhet të sigurojnë një dhomë private ose vendndodhje alternative për qëllimin e shtrydhjes së qumështit të gjirit. **Hapësira e parashikuar për shtrydhjen e qumështit të gjirit nuk mund të jetë një banjë apo ndenjësë tualeti.**

Dhoma ose vendndodhja tjetër duhet:

- Të jetë pranë zonës së punës së një punonjëseje
- Të mundësojë dritë të mirë natyrore ose artificiale
- Të jetë private - të dy (nëna dhe fëmija) të jenë të mbrojtur nga pamja dhe pa ndërhyrje
- Të ketë ujë të rrjedhshëm, të aksesueshëm dhe të pastër pranë
- Të ketë një prizë elektrike (nëse vendi i punës furnizohet me energji elektrike)
- Të përfshijë një karrige
- Të sigurojë një tavolinë, tavolinë të vogël, banak ose sipërfaqe tjetër të sheshtë

Nuk ka nevojë të ketë një hapësirë të veçantë për çdo punonjëse që ushqen me gji. Një punëdhënës mund t'i kushtojë një dhomë të vetme ose një vend tjetër për shtrydhjen e qumështit të gjirit. Nëse ka më shumë se një punonjëse në të njëjtën kohë që ka nevojë për qasje në një dhomë laktacioni, një punëdhënës mund të përkushtojë një vendndodhje të centralizuar për t'u përdorur nga të gjitha punonjëset.

Çdo hapësirë e parashikuar për shtrydhjen e qumështit të gjirit duhet të jetë pranë zonës së punës së punonjësës(eve) që përdorin hapësirën. Hapësira duhet të jetë në distancë në këmbë dhe distanca nga vendndodhja nuk duhet të zgjasë ndjeshëm kohën e nevojshme të pushimit të punonjësës.

Punëdhënësit e vendosur në zona të përbashkëta pune, të tilla si ndërtesa zyrash, qendra tregtare dhe hapësira të ngjashme mund të punojnë së bashku për të krijuar dhe mirëmbajtur një dhomë të dedikuar për laktacion, për sa kohë që këto hapësira janë në një distancë të arsyeshme për punonjëset që përdorin dhomën. Çdo punëdhënës që përdor këtë hapësirë të përbashkët është individualisht përgjegjës për t'u siguruar që dhoma të plotësojë nevojat e punonjësëve të tyre.

Nëse nuk ka një dhomë ose hapësirë të veçantë në dispozicion për laktacion, një punëdhënës mund të përdorë një zyrë të lirë ose një dhomë tjetër të disponueshme përkohësisht. Kjo dhomë nuk duhet të jetë e aksesueshme për publikun ose punonjësit e tjerë ndërsa punonjësja e përdor atë për të shtrydhur qumështin e gjirit.

Si mjet i fundit, mund të përdoret një kabinë e disponueshme për shtrydhjen e qumështit të gjirit. Kabina mund të përdoret vetëm nëse është e mbyllur plotësisht me një ndarje dhe nuk është ndryshe e aksesueshme për publikun ose punonjësit e tjerë ndërsa përdoret për shtrydhjen e qumështit të gjirit. Muret e kabinës duhet të jenë të paktën shtatë metra të larta për të siguruar privatësinë e punonjës.

Për të siguruar privatësinë, nëse dhoma e laktacionit ka një dritare, ajo duhet të mbulohet me një perde, grilë ose mbulesë tjetër. Përveç kësaj, hapësira e laktacionit duhet të ketë një derë të pajisur me një bravë funksionale. Nëse kjo nuk është e mundur (si në rastin e një kabine të mbyllur plotësisht), si mjet i fundit, një punëdhënës duhet të përdorë një shenjë që informon se hapësira është në përdorim dhe jo e aksesueshme për punonjësit e tjerë ose publikun.

Nëse vendi i punës ka një frigorifer, punëdhënësit duhet t'i lejojnë punonjësve ta përdorë atë për të ruajtur qumështin e gjirit. Megjithatë, punëdhënësit nuk janë përgjegjës për sigurimin e ruajtjes së qumështit të shtrydhur të ruajtur në çdo frigorifer në vendin e punës. Punonjësve u kërkohet të ruajnë të gjithë qumështin e shtrydhur në enë të mbyllura dhe ta sjellin qumështin në shtëpi çdo mbrëmje.

Hapësira e caktuar për nxjerrjen e qumështit të gjirit duhet të mbahet e pastër gjatë gjithë kohës.

Nëse një punëdhënës do të shfaqte vështirësi të panevojshme në sigurimin e një hapësire me kërkesat e mësipërme, punëdhënësi duhet të sigurojë një dhomë ose vendndodhje tjetër - përveç banjës ose ndenjësës së tualetit - që është në afërsi të zonës së punës ku një punonjëse mund të shtrydhë qumështin e gjirit në privatësi dhe që plotëson sa më shumë nga kërkesat e mundshme. Vështirësitë e panevojshme përkufizohen në statut si "shkaktim i vështirësive ose shpenzimeve të konsiderueshme kur merren parasysh në lidhje me madhësinë, burimet financiare, natyrën ose strukturën e biznesit të punëdhënësit". **Megjithatë, një punëdhënës nuk mund t'i mohojë një punonjëseje të drejtën për shtrydhjen e qumështit të gjirit në vendin e punës për shkak të vështirësisë në gjetjen e një vendi.**

## DEPARTAMENTI I BURIMEVE TË PUNËS TË SHETIT TË NJU JORKUT

Nëse një punonjëse beson se po përjeton hakmarrje për nxjerrjen e qumështit të gjirit në vendin e punës ose se punëdhënësi i saj është në kundërshtim me këtë politikë, ajo duhet të kontaktojë Departamentin e Standardeve të Punës të Departamentit të Shtetit të Nju Jorkut. Na telefononi në **1-888-52-LABOR**, na dërgoni email në **LSAsk@labor.ny.gov** ose vizitoni faqen tonë të internetit në **dol.ny.gov/breast-milk-expression-workplace** për të paraqitur një ankesë.

Lista e zyrave tona është në dispozicion në **dol.ny.gov/location/contact-division-labor-standards**.

*Ankesat janë konfidenciale.*

## BURIMET FEDERALE

Ligji federal PUMP hyri në fuqi në vitin 2023, duke zgjeruar mbrojtjen për pothuajse të gjitha punonjëset që shtrydhin qumështin e gjirit në vendin e punës. Sipas Aktit PUMP, çdo punonjëse e mbuluar që nuk pajiset me pushime dhe hapësirë të përshtatshme deri në një vit pas lindjes së një fëmije, mund të paraqesë një ankesë në Departamentin e Punës të SHBA-së ose të ngrejë një padi kundër punëdhënësve. Për më shumë informacion, ju lutemi vizitoni **dol.gov/agencies/whd/pump-at-work**.